



Prishtinë: 28.03.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1131_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1890_01_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **25.02.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 28.03.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin I. I. nga Lipjani, me shifër të konsumatorit DFE - 56168, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1890_01_19** i datës 25.01.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 25.02.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se faturimi i kWh të shpenzuar në tarifën e ulët është bërë sipas regjistrimit të bërë në njehsor. KESCO në ankesë ka theksuar se sipas raportit të qendrës së kalibrimit ka rezultuar se njehsori bënë matje në dy tarifatat dhe se e ka një tiketë në tarifën e dytë por ka harxhim. KESCO në ankesë ka theksuar se DMK në ZRRE në arsyetimin e tyre kanë theksuar se kWh nuk figurojnë në CCP por që KESCO thekson se kWh nuk kanë mundur të jenë në CCP dhe se tek pas ndërrimit dhe shqyrtimit të njehsorit është konstatuar se njehsori ka shpenzuar në tarifën e dytë. KESCO në ankesë ka theksuar se vetëm ka bërë kalkulimin e kWh të shpenzuar në tarifën e dytë sipas raportit të kalibrimit. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1890_01_19 i datës 23.01.2019 për konsumatorin I. I. me shifër DFE - 56168 dhe të mbetet në fuqi korrigjimi shtesë i datës 10.05.2016 në vlerë prej 2066.00€ dhe 1211.28 €

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkalës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s faturimi i kWh të shpenzuar në tarifën e ulët është bërë sipas regjistrimit të bërë në njehsor dhe se sipas raportit të qendrës së kalibrimit ka rezultuar se



njehsori bënë matje në dy tarifatat dhe se e ka një tiketë në tarifën e dytë por ka harxhim, Bordi i ZRRE thekson se pas analizimit të procesverbalit të ndërrimit dhe heqjes së njehsorit elektrik nr.0629891 të datës 07.03.2016, punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.115528071 me gjendje TL=15745 kWh, dhe kanë vendosur për matje njehsorin e ri elektrik me nr.64647842 me gjendje të shpenzimeve TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Në këtë procesverbal është te shpenzimi i njehsorit elektrik nr.5528071 është evidentuar vetëm shpenzimi i njëjës tarifë. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së bërë procesverbalit të kontrollimit detal të njehsorit të energjisë elektrike me nr.38/21, të datës 21.03.2016 dhe kanë vërejtur se punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë evidentuar se njehsori elektrik nr.115528071 vulat i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka, por që ka të dy tarifatat dhe atë me shpenzim, por që njehsori në fjalë ka një etiket e cila e ka mbuluar tarifën e dytë. Për këtë Bordi i ZRRE thekson se edhe organi i shkallës së parë në vendim nuk e ka mohuar që njehsori t'i ketë të dy tarifatat por që ai njehsor ka pasur të mbuluar me tiketë shpenzimin e tarifës së dytë. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes procesverbalin e qendrës së kalibrimit, si dhe fotografitë e njehsorit elektrik, dhe se nga fotografitë e siguruara vërtetohet qartë se kilovatët e kontestuar kanë qenë të mbuluar me një tiketë dhe se në tiketën e vendosur theksohet se të dhënat nuk duhet të përdoret për llogaritje (faturim), përderisa KESCO pa bërë asnjë analizë i ka kalkuluar ato dhe ia ka faturuar konsumatorit.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit të KESCO se DMK në ZRRE në arsyetimin e tyre kanë theksuar se kWh nuk figurojnë në CCP por që KESCO thekson se kWh nuk kanë mundur të jenë në CCP dhe se tek pas ndërrimit dhe shqyrtimit të njehsorit është konstatuar se njehsori ka shpenzim në tarifën e dytë, Bordi i ZRRE-së thekson se pas analizave të bëra shkresave të lëndës është vërejtur se kWh e faturuar nuk figurojnë në CCP, e që kjo është në kundërshtim me rregullat dhe procedurat në fuqi që kanë të bëjnë me faturimin e konsumatorëve, si dhe punëtorët e autorizuar të KEDS-it për çdo muaj kanë për obligim leximin dhe faturimin e konsumatorëve tarifor. Duhet theksuar se bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“Konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifatat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*, andaj ndërmarrja e energjisë duhet të faturojë borxhin e energjisë elektrike sipas shpenzimeve që bënë konsumatori në pikën matëse por që në asnjë rast të faturojë shpenzime të cilat konsumatori nuk i ka krijuar.

Për të vërtetuar edhe më saktë se faturimi i shpenzimit të energjisë elektrike i tarifës së dytë së njehsorit elektrik nr.11528071 e dëshmon edhe fakti se gjatë krahasimit të shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin elektrik kontestues dhe njehsorin e ri shpenzimi i energjisë elektrike nuk ndryshon. Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë rrjedhës së energjisë elektrike me njehsorin elektrik nr.115528071 dhe konstaton se konsumatori nga fillimi deri në periudhën mars 2016 ka faturim vetëm në tarifën e lartë. Bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike me dy njehsorët elektrik, njehsorin e vjetër nr.115528071 dhe njehsorin e ri nr.64647842 konstaton se konsumatori nuk ka dallim në shpenzimin e energjisë elektrike. Mesatarja e shpenzimeve të konsumatorit me njehsorin e vjetër nr.115528071 për periudhat: 2012 – 722.33 kWh/muaj,, 2013 – 708.25 kWh/muaj, 2014 – 655.58 kWh/muaj dhe 2015 – **635.92 kWh/muaj kWh/muaj**, apo mesatarja mujore gjatë këtyre viteve 2012 – 2015 është 681 kWh/muaj, kurse me njehsorin e ri elektrik për periudhën 2017 – 841.58 kWh/muaj, 841 kWh/muaj si dhe periudhën 2018 është **646 kWh /muaj**. Bazuar në këtë vërtetohet se konsumatori nuk ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike me çka edhe vërtetohet se konsumatori me njehsorin nr. 5528071 nuk ka pasur shpenzim në tarifën e ulët andaj edhe nuk duhet të ngarkohet për konsum të supozuar dhe të pavërtetuar



Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit I. I. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.